

Aida Hoxha¹UDC: 35.077.2(497.115)
35.077.2(497.7)**KONFLIKTI ADMINISTRATIV**
АДМИНИСТРАТИВЕН СПОР
ADMINISTRATIVE CONFLICT**Abstract**

This research explores the concept, structure, and legal framework of administrative conflict, a critical issue in administrative law with a direct impact on the functioning of public institutions and the protection of individual rights. The study aims to provide an in-depth understanding of the causes and types of administrative disputes, the legal mechanisms for their resolution, and the implications these mechanisms have on legality, accountability, and transparency in public administration. The research combines normative and analytical methods, examining both legislation and court practice in Kosovo and North Macedonia. Key findings indicate that efficient resolution of administrative conflicts, especially through modern tools such as judicial digitization, can significantly reduce delays and increase public trust. This paper contributes to the development of administrative legal systems by identifying challenges and proposing recommendations for reform.

Keywords: *Administrative conflict, judicial control, public administration, legality, individual rights, legal reform, transparency.*

Hyrje

Konflikti administrativ përfaqëson një nga temat më komplekse dhe të ndjeshme në fushën e së drejtës administrative², duke pasur një ndikim të drejtpërdrejtë mbi funksionimin e institucioneve publike dhe të drejtat e individëve³.

¹ South East European University

1200 Tetovo, Republic of North Macedonia Tel: +38348729903

Email: ah33217@seeu.edu.mk

² Sokol Sadushi, *E Drejta Administrative* (Botimet EMAL, 2018), f. 233.

³ Arta Mandro, *E Drejta Administrative: Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike* (Tiranë, 2021), f. 145.

Njohuritë se administrata shtetërore paraqet mekanizëm kryesor për realizimin e një numri të rëndësishëm të punëve, se administrata shtetërore ka autorizime të gjëra dhe organizim të fortë, kërkon që mbi administratën të vihet një kontroll i shumanshëm, me qëllim që të kujdeset për ligjshmërinë dhe efikasitetin e veprimtarisë.⁴

Që të sigurohet ligjshmëri, përgjegjësi dhe efikasitet në punën e organeve të administratës shtetërore dhe shërbimeve publike, është e nevojshme që të kryhet një kontroll i cili nënkupton një aktivitet të ndjekjes së përhershme në realizimin e qëllimeve dhe punëve të caktuara dhe krahasim i rezultateve të arritura me qëllimin e caktuar, me mundësi të ndikimit korrigjues në rast të përjashtimit të tyre.⁵

Kontrolli i ligjshmërisë është kontroll i cili konsiston në verifikimin e veprimtarisë së organeve të administratës se është cenuar ligji, dispozita apo akti i përgjithshëm.⁶

Vlen të ceket se si bartës të kontrollit janë ato subjekte të cilat me norma juridike janë të autorizuar që të kryejnë një lloj mbikëqyrje të caktuar mbi administratën, duke i shfrytëzuar autorizimet kontrolluese e ato janë parlamenti, qeveria, vetë organet administrative, gjykata, prokuroria publike etj.

Ndërsa si organe mbi të cilat kryhet kontrolli janë ato subjekte pasive të cilët kontrollohen si shembull organizata të ndryshme administrative, drejtoritë lokale dhe vendore etj.

Ligji i RM-së për konflikt administrativ në mënyrë të qartë dhe padyshim e përcakton se qëllimi i konfliktit administrativ është mbrojtja gjyqësore e të drejtave dhe interesave juridik të personave juridik dhe fizik si dhe mbrojtja e ligjshmërisë.⁷

1. Parimet themelore të Ligjit për Konfliktet Administrative

Ligji për Konfliktet Administrative i Republikës së Kosovës përcakton një sërë parimesh themelore që sigurojnë drejtësi, ligjshmëri dhe mbrojtje të të drejtave të qytetarëve përballë administratës publike. Këto parime udhëheqin gjykatat administrative gjatë trajtimit të konflikteve dhe sigurojnë zhvillimin e një procedure të drejtë dhe efikase.

1.1 Parimi i ligjshmërisë

Ky parim e detyron gjykatën që të vendosë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi. Vendimi i gjykatës duhet të bazohet në normat pozitive ligjore dhe në interpretimin e drejtë të tyre.⁸

⁴ Stavileci. Esat, *Hyrje në Shkencat Administrative*, Prishtinë, 1997, f. 123

⁵ Stavileci. Esat, Sokoli. Agur, Batalli. Mirlinda, *E Drejta Administrative*, Prishtinë, 2010, f. 103.

⁶ Po aty. f. 116.

⁷ Ligji Për Konflikt Administrativ, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 62/06, neni. 1.

⁸ Ligji Nr. 02/L-28 për Konfliktet Administrative, neni 3.

1.2 Parimi i të drejtës për t'u deklaruar

Gjykata është e detyruar që t'i japë secilës palë mundësinë për t'u deklaruar për të gjitha kërkesat, pretendimet, faktet dhe çështjet juridike që lidhen me rastin. Përgjashtimisht, gjykata mund të vendosë pa e dëgjuar palën vetëm nëse kjo parashihet shprehimisht nga ligji⁹.

1.3 Parimi i shqyrtimit verbal dhe publik

Procedura gjyqësore duhet të zhvillohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, gojore dhe transparente. Seancat gjyqësore duhet të jenë publike, përveç rasteve kur ligji parashikon shqyrtim të mbyllur për arsye të veçanta, si mbrojtja e rendit publik apo e sekreteve zyrtare¹⁰.

1.4 Parimi i efikasitetit

Gjykata ka për obligim të zhvillojë procedurën në mënyrë të shpejtë dhe pa zvarritje, duke shmangur veprimet dhe shpenzimet e panevojshme. Ky parim synon parandalimin e abuzimeve procedurale dhe sigurimin e një vendimi brenda afateve ligjore të përcaktuara¹¹.

1.5 Parimi i ndihmës ndaj palës së painformuar

Në rastet kur palët janë të painformuara për të drejtat dhe detyrimet e tyre procedurale, gjykata ka detyrimin t'u ofrojë ndihmë në mënyrë që mosinformimi të mos rezultojë në humbjen e së drejtës së tyre. Ky parim është veçanërisht i rëndësishëm për mbrojtjen e interesave të qytetarëve që nuk kanë përfaqësim profesional në gjykatë¹².

2. Palët në konfliktin administrativ

Për dallim nga procedura administrative, ku mund të zhvillohet edhe pa praninë e dy palëve me interesa të kundërta, procedura administrative-gjyqësore kërkon doemos pjesëmarrjen e dy palëve me interesa të kundërta: paditësit dhe të paditurit, ndërsa gjykata vepron si palë neutrale që ushtron funksionin e arbitrit¹³.

Sipas Ligjit për Konfliktin Administrativ, palë në konfliktin administrativ mund të jenë: paditësi, i padituri dhe personi i interesuar¹⁴.

⁹ Po aty, neni 4, paragrafi 2.

¹⁰ Po aty, neni 7.

¹¹ Po aty, neni 5.

¹² Sadushi, Sokol, *E Drejta Administrative*, Botimet EMAL, Tiranë, 2018, f. 336–337.

¹³ Sadushi, Sokol, *E Drejta Administrative*, Botimet EMAL, Tiranë, 2018, f. 329.

¹⁴ Ligji Nr. 02/L-28 për Konfliktet Administrative, neni 9.

2.1 Paditësi

Paditës në konfliktin administrativ mund të jetë çdo person fizik apo juridik, si dhe avokati i popullit, shoqata, apo organizata të tjera, të cilat janë të autorizuar me ligj për të ngritur padi. Këta subjekte duhet të kenë interes të drejtpërdrejtë juridik, ose të jenë të legjitimuar për të kundërshtuar ligjshmërinë e një akti administrativ të nxjerrë nga organi administrativ¹⁵.

2.2 I padituri

Pala e paditur në konfliktin administrativ është zakonisht një organ shtetëror ose një organizatë që ushtron autorizime publike¹⁶. Pasi konflikti ngrihet ndaj një akti administrativ përfundimtar apo heshtjes së administratës, i padituri është organi që e ka nxjerrë aktin në fjalë, ose që ka dështuar ta nxjerrë atë brenda afatit ligjor¹⁷.

Nëse administrata nuk e nxjerr aktin brenda afatit të paraparë, atëherë kemi të bëjmë me fenomenin e heshtjes administrative, e cila po ashtu përbën bazë për ngritjen e padisë në konflikt administrativ.

2.3 Personi i interesuar

Përveç paditësit dhe të paditurit, në konfliktin administrativ mund të marrë pjesë edhe personi i interesuar, i cili nuk është palë fillestare në konflikt, por interesi i tij juridik mund të preket nga vendimi i gjykatës. Ky person ka të drejtë të ndërhyjë në procedurë, dhe gjykata duhet ta njoftojë për të drejtën e pjesëmarrjes në proces, nëse plotësohen kushtet ligjore¹⁸.

2.4 Afati për paraqitjen e padisë

Procedura për konfliktin administrativ inicohet me padi që synon të sfidojë ligjshmërinë e një akti administrativ. Padia duhet të paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita kur akti administrativ përfundimtar i dorëzohet palës. Ky afat vlen edhe për subjektet e autorizuar që nuk janë vetë palë direkte në çështje, por që kanë të drejtë ligjore për ta paraqitur padinë¹⁹.

3. Padia dhe përmbajtja e saj në konfliktin administrativ

Padia për konflikt administrativ është mjeti themelor procedural me të cilin një subjekt juridik apo person fizik kërkon nga gjykata të shqyrtojë dhe të vlerësojë ligjshmërinë e një akti administrativ përfundimtar. Padia mund të

¹⁵ Po aty, neni 10, paragrafi 1.

¹⁶ Po aty, neni 10, paragrafi 2.

¹⁷ Po aty, neni 15 dhe neni 17.

¹⁸ Po aty, neni 11.

¹⁹ Po aty, neni 18.

bëhet me shkrim dhe të dërgohet përmes postës, por edhe me gojë, përmes deklarimit në procesverbal në gjykatë²⁰.

Dita e dorëzimit të padisë konsiderohet ajo kur:

- është paraqitur përmes postës së regjistruar, ose
- është deklaruar me procesverbal në gjykatë²¹.

Në rastet kur padia i është dorëzuar një organi tjetër jo kompetent, por ka qenë e paraqitur brenda afatit dhe më pas i ka arritur gjykatës pas skadimit të tij, ajo do të konsiderohet e paraqitur në afat, nëse shkaku i dorëzimit në organin e gabuar ka qenë mosdija apo gabimi i qartë i paditësit²². Kjo dispozitë mbron të drejtën e qasjes në drejtësi dhe shmang penalizimin për gabime të paditura të palës.

3.1 Dokumentacioni i bashkëlidhur

Paditësi duhet t'ia bashkëngjisë padisë:

- Aktin administrativ që kundërshton,
- Një kopje të padisë dhe të dokumenteve shoqëruese për organin e paditur,
- Kopje për çdo person tjetër të interesuar²³.

Sipas nenit 30 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, padia është parashtrimi formal që duhet të përmbajë elemente të detyrueshme për të qenë e vlefshme²⁴.

4. Organet kompetente (përgjegjëse) për zgjidhjen e konfliktit administrativ

Zgjidhja e konfliktit administrativ është e lidhur ngushtë me mënyrën e organizimit të kontrollit mbi aktet administrative. Në të drejtën krahasuese dhe në teorinë juridike, janë identifikuar tre sisteme kryesore për organizimin e kontrollit gjyqësor ndaj administratës publike dhe për zgjidhjen e konflikteve administrative:

4.1 Sistemi administrativ (jo-gjyqësor)

Ky sistem njihet si sistem ku kontrolli i ligjshmërisë së akteve administrative u besohet vetë organeve të administratës publike. Në këtë rast, zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis qytetarëve dhe administratës bëhet nga vetë

²⁰ Ligji Nr. 02/L-28 për Konfliktet Administrative, neni 29, paragrafi 1.

²¹ Po aty, neni 29, paragrafi 2.

²² Po aty, neni 29, paragrafi 3.

²³ Po aty, neni 30, paragrafi 2.

²⁴ Po aty, neni 30, paragrafi 1.

administrata, në mënyrë hierarkike, nëpërmjet ankesës administrative ose mjeteve të tjera të brendshme juridike²⁵.

Ky sistem është karakteristik për modele jo-demokratike ose gjysmë-autoritare, dhe është aplikuar në të kaluarën, veçanërisht në Bashkimin Sovjetik dhe shtetet e Lindjes së Evropës, ku pushteti gjyqësor nuk ka pasur rol të pavarur në kontrollin e vendimeve administrative²⁶.

4.2 Sistemi i gjykatave administrative (sistemi kontinental)

Ky sistem, i quajtur ndryshe edhe sistemi kontinental evropian, karakterizohet nga krijimi i gjykatave të veçanta administrative të cilat janë kompetente për të gjykuar konfliktet ndërmjet qytetarëve dhe organeve administrative. Ky model është i përhapur gjerësisht në vende si Franca, Gjermania, Italia, dhe është një shtyllë qendrore e sistemit të së drejtës publike kontinentale²⁷.

Këto gjykata funksionojnë në mënyrë të pavarur nga organet administrative dhe garantojnë kontroll efektiv dhe të paanshëm mbi administratën. Megjithatë, në disa shtete – si në Francë – këto gjykata nuk janë pjesë formale e sistemit të zakonshëm gjyqësor, por përbëjnë një juridiksion të veçantë administrativ²⁸.

4.3 Sistemi i gjykatave të përgjithshme

Sipas këtij sistemi, kompetenca për zgjidhjen e konflikteve administrative i jepet gjykatave të rregullta (me juridiksion të përgjithshëm). Në këtë model nuk ekzistojnë gjykata të specializuara administrative, por çështjet administrative trajtohen nga të njëjtat gjykata që gjykojnë edhe në çështje civile apo penale. Ky model është më i përhapur në vendet e sistemit anglosakson, si Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA²⁹.

Ky sistem ka përparësinë e unitetit të gjyqësorit, por në disa raste mund të mungojë ekspertiza e specializuar në të drejtën administrative, që është thelbësore për rregullimin e marrëdhënieve mes individëve dhe administratës.

5. Kontrolli gjyqësor i akteve administrative në Kosovë

Në Republikën e Kosovës, kontrolli gjyqësor i akteve administrative realizohet nëpërmjet procedurës së konfliktit administrativ, i cili zhvillohet në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si gjykatë kompetente në shkallën e parë³⁰. Kjo është në përputhje me

²⁵ Agron Bajrami, *E Drejta Administrative*, Prishtinë, 2020, f. 223.

²⁶ Ibid., f. 224

²⁷ Dervish Daka, *E Drejta Administrative dhe Gjykata Administrative në Kosovë*, Prishtinë, 2017, f. 189.

²⁸ Pierre Chapus, *Droit administratif général*, Paris: Montchrestien, 2010, f. 97.

²⁹ Tom Bingham, *The Rule of Law*, Penguin Books, 2011, f. 88.

³⁰ Ligji për Konfliktin Administrativ, neni 1.

nenin 14 të Ligjit për Gjykatat (nr. 03/L-199), që përcakton kompetencën për gjykimin e padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe çështjeve të tjera të përcaktuara me ligj³¹. Konflikti administrativ lind kur procedura administrative është përfunduar dhe është nxjerrë një akt administrativ përfundimtar, kundër të cilit nuk ka mjete të tjera juridike në administratë. Në këtë rast, pala e interesuar ka të drejtë të kërkojë mbrojtje gjyqësore përmes padisë, me qëllim të kontrollit të ligjshmërisë së aktit administrativ³². Përveç kësaj, konflikti administrativ mund të iniciohet edhe ndaj akteve administrative të shkallës së parë, në rastet kur ankesa është e përjashtuar me ligj³³. Po ashtu, procedura gjyqësore mund të nisë edhe për shkak të heshtjes përfundimtare të administratës, kur organi kompetent nuk nxjerr vendim brenda afatit ligjor³⁴. Në mungesë të një ligji të ri për konfliktin administrativ, Ligji i RSFJ-së për Konfliktin Administrativ (Gazeta Zyrtare nr. 4/77) vazhdon të zbatohet në Kosovë, për aq kohë sa është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sipas nenit 145 të saj³⁵. Ky regjim juridik është trashëgimi e përbashkët e vendeve të dala nga ish-Jugosllavia (p.sh. Maqedonia e Veriut, Sllovenia, Kroacia, Mali i Zi), ku sistemi i kontrollit të akteve administrative mbështetet në parime të përbashkëta³⁶.

6. E drejta për ankesë në konfliktin administrativ

Ankesa është mjet i rregullt juridik dhe një garanci thelbësore për sigurimin e ligjshmërisë dhe të drejtave të palëve në procesin administrativ³⁷. Ajo mund të paraqitet kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë vetëm nëse është e paraparë shprehimisht në Ligjin për Konfliktin Administrativ. Afati për paraqitjen e saj është 15 ditë nga dita e pranimit të vendimit gjyqësor³⁸. Ankesa mund të ushtrohet nga Pala paditëse, Pala e paditur, Personi i interesuar - nëse është i pakënaqur me vendimin e gjykatës³⁹. Ankesa duhet të përmbajë: Identifikimin e vendimit që kontestohet si dhe shkaqet për të cilat kërkohet prishja ose ndryshimi i vendimit⁴⁰. Gjykata e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të formës dhe afatit të ankesës, mund: Ta hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, të vonuar ose të paraqitur nga personi i paautorizuar; Ta refuzojë ankesën si të pabazuar dhe të vërtetojë aktgjykimin e shkallës së parë; Ta

³¹ Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, neni 14.

³² Dervish Daka, *E drejta Administrative dhe Gjykata Administrative në Kosovë*, Prishtinë, 2017, f. 195.

³³ Ibid.

³⁴ Po aty, f. 196.

³⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 145, paragrafi 2.

³⁶ Agron Bajrami, *E drejta Administrative*, Prishtinë, 2020, f. 228.

³⁷ Ibid., f. 230.

³⁸ Ligji për Konfliktin Administrativ, neni 62.

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Ligji për Procedurën Kontestimore, neni 195.

prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthejë çështjen për rigjykim në shkallën e parë; Ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë, nëse janë përmbushur kushtet ligjore për një vendim merit⁴¹. Në rast kthimi të çështjes në rigjykim, udhëzimet dhe vërejtjet e gjykatës së shkallës së dytë janë obligative për gjykatën e shkallës së parë. Kjo garanton jo vetëm respektimin e standardeve të ligjshmërisë, por edhe efektivitetin procedural dhe sigurimin e të drejtës në një proces të rregullt gjyqësor⁴².

7. Mjetet e jashtëzakonshme juridike në konfliktin administrativ

Ligji për Konfliktet Administrative në Republikën e Kosovës parasheh tre mjete të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë në procedurën e konfliktit administrativ: 1. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor; 2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë; dhe 3. Rishikimi⁴³.

7.1. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm

Ky mjet juridik përdoret kundër një vendimi të formës së prerë dhe duhet të parashtrahet në gjykatë brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit⁴⁴. Nëse kërkesa është e paplotë, e paqartë ose përmban mangësi procedurale, gjykata në përputhje me nenin 33 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, i jep afat prej 8 ditësh ushtruesit për të mënjeluar të metat⁴⁵. Nëse këto nuk mënjahen, kërkesa hidhet poshtë me vendim. Nëse kërkesa është e plotë, ajo i dërgohet palës së kundërt, e cila ka të drejtë të japë përgjigje brenda 15 ditësh nga dita e pranimi. Gjykata shqyrton kërkesën në seancë të mbyllur dhe e kufizon vlerësimin vetëm brenda kufijve të kërkesës. Gjykata mund të: Refuzojë kërkesën si të pabazuar apo ta aprovojë kërkesën dhe të anulojë ose ndryshojë vendimin gjyqësor kundër të cilit është paraqitur kërkesa⁴⁶. Nëse vendimi anulohet, çështja i rikthehet gjykatës që e ka nxjerrë vendimin për shqyrtim të ri. Në këtë rast, ajo është e detyruar të ndjekë udhëzimet e gjykatës që e ka miratuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm⁴⁷.

7.2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kjo kërkesë mund të parashtrahet kur ka shkelje të ligjit, pavarësisht nëse akti administrativ i kontestuar është në favor të një personi fizik, juridik,

⁴¹ Ligji për Konfliktin Administrativ, neni 63 dhe neni 64.

⁴² Ligji për Procedurën Kontestimore, nenet 194-210.

⁴³ Shih Ligjin për Konfliktet Administrative ("Gazeta zyrtare e RSFJ", nr. 4/77), zbatueshëm në Republikën e Kosovës në përputhje me nenin 145 të Kushtetutës së Kosovës.

⁴⁴ Po aty, neni përkatës që përcakton afatet për paraqitjen e mjeteve juridike të jashtëzakonshme.

⁴⁵ Ligji për Konfliktet Administrative, neni 33

⁴⁶ Po aty, dispozitat për vendimmarrje mbi kërkesat e jashtëzakonshme.

⁴⁷ Po aty, referuar praktikës gjyqësore dhe obligimeve të instancave më të ulëta.

apo kur vendimi është në kundërshtim me interesin publik. Kjo kërkesë ka karakter objektiv, pasi synon të ruajë ligjshmërinë në përgjithësi, jo vetëm interesin individual⁴⁸.

7.3. Rishikimi

Rishikimi është një mjet tjetër i jashtëzakonshëm që mund të kërkohej kur paraqiten prova apo rrethana të reja të cilat e bëjnë të besueshëm ekzistimin e një shkaku për ndryshimin e vendimit gjyqësor. Kërkesa duhet të përmbajë:

- Bazën ligjore të rishikimit,
- Provat dhe rrethanat e reja,
- Argumentet se kërkesa është paraqitur në afatin ligjor dhe me dokumentacion mbështetës⁴⁹.

7.4. Organizimi gjyqësor në konfliktet administrative

Çdo person fizik ose juridik mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore, në Departamentin për Çështje Administrative, ku çështjet trajtohen nga një gjyqtar, përveç nëse ligji përcakton ndryshe⁵⁰. Brenda këtij departamenti funksionon Divizioni Fiskal, që shqyrton paditë kundër vendimeve përfundimtare të Administratës Tatimore, Doganave dhe administratës komunale, në lidhje me taksat dhe detyrimet e tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi⁵¹. Në shkallën e dytë, shqyrtimi bëhet nga Gjykata e Apelit, përmes një kolegji të përbërë prej tre gjyqtarësh. Ndërsa për mjetet juridike të jashtëzakonshme vendos Gjykata Supreme e Kosovës, gjithashtu përmes një kolegji gjyqtarësh⁵².

Conclusion

In conclusion, it can be stated that administrative conflict represents an essential and highly effective mechanism for ensuring the legality of administrative acts and for protecting the rights of the parties involved. It provides a transparent and fair judicial process, guaranteeing that administrative bodies act within the boundaries of the law. In doing so, it strengthens public trust in administrative justice and upholds the rule of law within society.

⁴⁸ Shih gjithashtu praktikat e Gjykatës Supreme të Kosovës mbi mbrojtjen e ligjshmërisë.

⁴⁹ Shih standardet për rishikimin në ligjin procedural dhe aplikimin analog nga Ligji i Procedurës Kontestimore.

⁵⁰ Ligji për Gjykatat, nr. 06/L-054, neni për kompetencat e gjykatave themelore.

⁵¹ Ligji për Administratën Tatimore dhe Doganore, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal.

⁵² Ligji për Gjykatën Supreme dhe kompetencat e saj mbi mjete juridike të jashtëzakonshme.

Recensentë:

Prof. ass. dr. Artan Fejzullahu

Prof. dr. Blerton Sinani

Bibliografia:

Literatura (libra):

1. Bajrami, Agron. *E drejta administrative*. Prishtinë, 2020, f. 223.
2. Bajrami, Agron. *E drejta administrative*. Prishtinë, 2020, f. 228.
3. Bingham, Tom. *The Rule of Law*. Penguin Books, 2011, f. 88.
4. Chapus, Pierre. *Droit administratif général*. Paris: Montchrestien, 2010, f. 97.
5. Daka, Dervish. *E drejta administrative dhe Gjykata Administrative në Kosovë*. Prishtinë, 2017, f. 189.
6. Daka, Dervish. *E drejta administrative dhe Gjykata Administrative në Kosovë*. Prishtinë, 2017, f. 195.
7. Mandro, Arta. *E drejta administrative: Organizimi dhe funksionimi i administratës publike*. Tiranë, 2021, f. 145.
8. Sadushi, Sokol. *E drejta administrative*. Botimet EMAL, Tiranë, 2018, f. 233.
9. Sadushi, Sokol. *E drejta administrative*. Botimet EMAL, Tiranë, 2018, f. 329.
10. Sadushi, Sokol. *E drejta administrative*. Botimet EMAL, Tiranë, 2018, f. 336–337.
11. Stavileci, Esat. *Hyrje në shkencat administrative*. Prishtinë, 1997, f. 123.
12. Stavileci, Esat; Sokoli, Agur; Batalli, Mirlinda. *E drejta administrative*. Prishtinë, 2010, f. 103.

Legjislacioni dhe dokumente zyrtare:

13. *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 145, paragrafi 2.
14. *Ligji për Gjykatat*, nr. 03/L-199, neni 14.
15. *Ligji për Gjykatat*, nr. 06/L-054, neni për kompetencat e gjykatave themelore.
16. *Ligji për Gjykatën Supreme dhe kompetencat e saj mbi mjete juridike të jashtëzakonshme*.
17. *Ligji për Administratën Tatimore dhe Doganore; Ligji për Financat e Pushtetit Lokal*.
18. *Ligji për Procedurën Kontestimore*, neni 195.
19. *Ligji për Procedurën Kontestimore*, nenet 194–210.

20. *Ligji Nr. 02/L-28 për Konfliktet Administrative*, neni 3.
21. *Ligji Nr. 02/L-28 për Konfliktet Administrative*, neni 9.
22. *Ligji Nr. 02/L-28 për Konfliktet Administrative*, neni 29, paragrafi 1.
23. *Ligji për Konfliktin Administrativ*, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 62/06, neni 1.
24. *Ligji për Konfliktin Administrativ*, neni 1.
25. *Ligji për Konfliktin Administrativ*, neni 33.
26. *Ligji për Konfliktin Administrativ*, neni 62.
27. *Ligji për Konfliktin Administrativ*, nenet 63 dhe 64.
28. *Shih Ligjin për Konfliktet Administrative* (“Gazeta zyrtare e RSFJ-së”, nr. 4/77), zbatueshëm në Republikën e Kosovës në përputhje me nenin 145 të Kushtetutës së Kosovës.
29. *Shih gjithashtu praktikën e Gjykatës Supreme të Kosovës mbi mbrojtjen e ligjshmërisë.*
30. *Shih standardet për rishikimin në ligjin procedural dhe aplikimin analog nga Ligji i Procedurës Kontestimore.*